

AKT – THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"PLATFORMA KONSTRUKSION" SHPK

Sot me datën 17/08/2021 (dymijë e njëzet e një), unë ortaku themelues :

- **Z.Amarildo Jaçelli** I biri I Shefket , i datëlindjes 12 Mars 1992, lindur në Pogradec dhe banues në Tiranë person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. Leternjoftimi J20312048L .

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar* " PLATFORMA KONSTRUKSION" SHPK.

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË


Shoqëria do të quhet " PLATFORMA KONSTRUKSION" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, "Lagjja nr 11, Rruga "Aleksander Goga",Zona kadastrale 8514, Godina me nr pasurie 1/279,Kati dyte,Durrës " .

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e: " Projektme civile dhe industriale, punime të ndryshme ndërtimi si armim dhe disarmim armature dërrase dhe metalike, përpunime hekur ndërtimi, mirëmbajtje godinash dhe montim te kapanoneve industrial.Kryerja e aktiviteteve tregtare në fushën projektimit dhe ndërtimit të veprave të ndryshme civile, private dhe publike, dhe rikonstruksioni I tyre, Projektim dhe ndërtim i rrjeteve hidraulike, elektrike, të ajrimit dhe kondicionimit, restaurim dhe mirëmbajtje vepra arti dhe monumente kulture. Ndërtim ujësjellësash, kanale vaditës dhe kullues, impiante vaditëse, dhe vepra te tjera mbrojtëse. Ndërtim rrugësh dhe urash të të gjitha kategorive, diga, tunele, galeri, si dhe mirëmbajtjen e tyre përfshirë dhe sinajlistikë rrugore. Prodhim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit. Import dhe eksport i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit, hidraulike, elektrike, etj. Vlerësimi i pasurive të paluajtshme.Shoqëria mund të kryejë dhe



veprimtari të tjera ndihmëse të cilat mbështesin arritjen e qëllimit të saj kryesor në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

NENI 4
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë **”PLATFORMA KONSTRUKSION” SHPK** është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve është i ndare si vijon:

1.Amarildo Jaçelli zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.

NENI 5
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z.Amarildo Jacçelli, me ID J20312048L**, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit ”Per Shoqerite Tregtare”.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8



NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9

LIKUIDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjisfacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10

MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Tiranë për zgjidhje.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË
"PLATFORMA KONSTRUKSION" SH.P.K**

Amarildo Jaçelli

Amarildo Jaçelli

